



AZHBR: Skema Kombëtare financon 59,621 fermerë

Faqe 4



Skema e Investimeve, AZHBR përmbyll ditët informuese me fermerët

Faqe 4



Mbahet takimi i Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD II, angazhim për adresimin e problematikave

Faqe 2



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit tetor 2024

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 496
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

UNIDO DHE UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS BASHKOHEN PËR TË MODERNIZUAR AGROBIZNESIN SHQIPTAR ME PLATFORMËN DIXHITALE

TAKIME NË SHKODËR DHE KORÇË PËR KRIJIMIN E GW: NXITJA E BASHKËPUNIMIT MES AKTORËVE LOKALË SI KATALIZATORË PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

UNIDO vjen në ndihmë të Shqipërisë në forcimin e infrastrukturës së cilësisë dhe për përmbushjen e kërkesave të standardeve ndërkombëtare për qëndrueshmëri si dhe duke mbështetur e promovuar zhvillimin afatgjatë të komuniteteve, në kuadër të Programit Global për Cilësinë dhe Standardeve (GQSP) me mbështetje nga SECO

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Balluku: Bashkitë në ndihmë të fermerëve për pajisjen me lejendërtimi për serrat



Faqe 2

FINANCIM

VanHorn: Një klimë pozitive biznesi, thelbësore për rritjen e investimeve amerikane



Faqe 4

KËNDI I BOTIMEVE TË REJA PËR BUJQËSINË



Ngruhja globale dhe teknologjitë bujqësore zbatuar në nivel ferme, të cilat kufizojnë rreziqet e saj

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Përfaqësues të 22 vendeve në samitin parlamentar "Rruga drejt sistemeve gjithëpërfshirëse dhe fleksible agroushqimore" Fq.4
- Bashkëpunim me BERZH për përgatitjen e sipërmarrjeve të vogla për tregjet evropiane Fq.4
- Krijohet regjistri për kthimin e garancive shtetërore Fq.5
- Rama: Masa drastike për çdo biznes të vogël Fq.5
- Kalendari bujqësor, muaji nëntor 2024 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

BUJQËSI

Denaj: Kultivimi në tokë të kripur ka rritur prodhimin e shegës



Faqe 2

TEMA TË DITËS

Mbahet takimi i Komitetit të Monitorimit të programit IPARD II, angazhim për adresimin e problematikave

U mbajt në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural takimi i 13-të i Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD II 2014 – 2020, strukturë e cila mbikëqyr zbatimin e këtij programi.

Takimet e Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD II, në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, organizohen të paktën dy herë në vit dhe kryesohet nga Ministri, në cilësinë e kryetarit të këtij

nevojat e identifikuar gjatë zbatimit të këtij programi.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj duke informuar për takimin vuri në dukje se programi IPARD mbështet sektorin bujqësor dhe zhvillimin rural, duke ndihmuar fermerët dhe agrobizneset shqiptare me një impakt të drejtpërdrejtë në punësim, përmirësimin e jetesës në zonat rurale dhe përafrimin me standardet e BE-së.

IPARD II përmes 4 thirrjeve për aplikime; sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të IPARD; aktivitetet e organizuara në lidhje me komunikimin dhe vizibilitetin, takimet dhe ditët informuese me fermerët etj.;

Po ashtu, palët u informuan për ecurinë dhe progresin e aktivitetëve të vlerësimit të këtij programi.

Në këtë takim u prezantuan edhe materialet informuese, për takimet e realizuara me fermerët, agro-bizneset etj., të cilat gjenden edhe në faqet respektive të MBZHR dhe AZHBR.

Nga zbatimi i Programit IPARD II janë mbështetur investime në mekanikë bujqësore dhe shtim sipërfaqesh të mbjella; investime në subjekte agroturistikë; investime në serra; pika grumbullimi; investime në kantina dhe vreshta; fabrika përpunimi agro-ushqimore; përafrimin gradual me standardet, politikat dhe praktikën e BE-së, etj.

Programi ka ofruar mbështetje për sipërmarrësit e rinj (nën 40 vjeç) dhe sipërmarrësit



Komiteti.

Komiteti i Monitorimit monitoron efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD, duke shqyrtuar periodikisht progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuar në këtë program.

Në takim ishin të pranishëm anëtarët e Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD II, që ka në përbërje përfaqësues të shoqatave dhe grupeve të interesit që veprojnë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministrive të tjera të linjës, si anëtarë me të drejtë vote. Gjithashtu, në takim ishin të pranishëm përfaqësues të gjitha strukturave IPARD, përfaqësues të Komisionit Evropian dhe delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Të gjitha strukturat e pranishme të IPARD morën angazhimin maksimal për t'i dhënë zgjidhje dhe adresuar me hapa konkrete problematikën dhe

Programi IPARD synon mbështetjen e sektorit bujqësor dhe zhvillimin rural, duke



nxitur zhvillimin ekonomik në zonat rurale, përmirësimin e cilësisë së jetesës, dhe të përgatisë sektorët bujqësorë për tregun konkurrues të BE-së.

Në takim të gjithë të pranishmit u informuan në lidhje me implementimin e programit IPARD II dhe IPARD III në rajon; zbatimin e programit

rështet gra, duke krijuar mjedisin mundësues për rritjen dhe fuqizimin e të rinjve dhe grave të angazhuar në sektorin bujqësor.

Gjithashtu, programi IPARD II ka impaktuar direkt në nxitjen e punësimit duke krijuar vendeve të reja të pune të lidhura me diversifikimin e aktivitetëve bujqësore dhe jo bujqësore në fermë dhe jashtë saj.

caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.

Në njoftimin e publikuar, Autoriteti i Konkurrencës thekson se shkelja e ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, në

(Vijon në faqen 7)

Balluku: Bashkitë në ndihmë të fermerëve për pajisjen me lejendërtimi për serrat

Zëvendëskryeministrja njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku kërkoi nga drejtuesit e bashkive bashkëpunim maksimal me fermerët për pajisjen me

do të kryhet online", deklaroi Balluku.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj deklaroi se Skema Kombëtare e Investimeve në Bujqësi prej 1.5

shumë fermerëve.

"Sot nuk mund të jesh vetëm një kompani e regjistruar, por rëndësi ka edhe një NIPT-fermeri dhe vetëm me NIPT-in e fermerit mund të aplikosh



lejendërtimi serrash.

Në takimin e zhvilluar në Lushnjë për prezantimin e Skemës Kombëtare të Investimeve, ku e pranishme ishte edhe ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, Balluku tha se për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion të fermerëve për të përfutuar nga kjo skemë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka marrë përsipër të ndihmojë fermerët për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për të përfutuar nga kjo skemë dhe e gjithë procedura mund të kryhet edhe fizikisht.

"Qeveria shqiptare ofron mbi 99.9% të shërbimeve online, por duke pasur parasysh kohën e shkurtër dhe vështirësinë që ju hasni për të shkuar online, Ministria e Bujqësisë ka marrë përsipër që ju fizikisht të shkoni të dorëzoni dokumentacionin dhe të procedoni sa më parë. Vitin që vjen edhe ky shërbim

miliardë lekësh, nismë e qeverisë shqiptare, synon zhvillimin e ekonomisë bujqësore dhe modernizimin e kësaj të fundit.

"Kjo është një skemë paralele me Skemën e Subvencioneve që ne kemi filluar ta disbursojmë dhe deri në fund të vitit do ta disbursojmë në llogaritë tuaja të plotë. Por nuk mund vetëm të prodhojmë, në qoftë se nuk ndërtojmë shtëpinë e prodhimit, serrat. Nuk mundemi dot të mbarësojmë në qoftë se kushtet e bagëtive tona nuk janë ato që kërkohen në standardet e Bashkimit Europian", tha Denaj.

Përmes kësaj skeme, tha ministria, fermerët ndihmohen në rritjen e sipërfaqeve në hektarë në investime në serra dhe për ndërtime të reja për stabilimentet e mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve.

Ajo po ashtu, Denaj theksoi se janë thjeshtuar procedurat në krahasim me fondet e mëparshme të investimeve për të mundësuar aplikimin e sa më

përtej dokumentacionit tjetër që kërkohet siç janë lejet e ndërtimit në rastin e dy masave të para, por në mekanikë bujqësore mjafton vetëm një ofertë e mekanikës bujqësore", tha ajo.

Edhe akuakultura është një zë shumë i rëndësishëm. Sipas ministres Denaj, po synohet që me mbështetjen përmes skemave kombëtare prodhimi të shkojë nga nga 9 600 tonë në 30 mijë tonë në 2030-ën.

Ministria Denaj u shpreh se skemat e mbështetjes në dispozicion të fermerëve i shërbejnë objektivit të qeverisë për të arritur në vlerën e eksporteve prej 1 miliardë dollarësh në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm.

"Sot jemi në gjysmë të rrugës dhe prandaj këto skema investimesh janë një mbështetje e drejtpërdrejtë për të rritur sipërfaqen në hektarë, të cilat në 5 vite kanë shkuar nga 1000 ha në 2200 dhe në 5 vitet e tjera ne synojmë përsëri ta dyfishojmë", tha ajo.

Denaj: Kultivimi në tokë të kripur ka rritur prodhimin e shegës

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau historinë e suksesit në prodhimin e shegëve.

"Agro Iliria" me një aktivitet të suksesshëm prej 10 vitesh, kultivon shegë të varitetit "Wonderful" në një sipërfaqe prej 100 hektarë tokë. Falë teknologjisë së avancuar, kultivimi në tokë të kripur ka rezultuar jashtëzakonisht i suksesshëm dhe prodhimi i shegës shitet si në tregun vendas, ashtu edhe jashtë vendit", u shpreh ministria Denaj në rrjetet sociale.

Grupi "Agro Iliria" po zhvillon një plan investimi shumëdimensional që përfshin 1100 hektarë tokë për rritjen e shegës "goji berry", një hapësirë për agroturizëm. Investimi fillestar

është 6.6 milionë euro, por pritet të rritet në vitet në vijim.

Ky investim është një nga shembujt ku mund të shohësh se si ka marrë jetë dhe zhvillohet një nga projektet e rëndësishme strategjike në fushën e bujqësisë.

Ky sistem është tërësisht një risi në Shqipëri, por është konsultuar me një ekspert nga Izraeli. Hap pas hapi, sistemi u është përshtatur kushteve të Shqipërisë duke çuar në një histori të mirëfilltë suksesi.



Nis monitorimi i furrave për çmimin e bukës - Autoriteti i Konkurrencës, në terren për kontrollin e sjelljeve abuzuese

Autoriteti i Konkurrencës ka nisur monitorimin e tregut të furrave të bukës lidhur me rritjen e çmimit të prodhimit dhe tregimit të bukës. Ky veprim vjen pas hyrjes në fuqi të vendimit të Entit Rregullator të Energjisë që përcaktonte ndryshimin e çmimit të energjisë për furrat e bukës që tregtojnë edhe prodhime pasticerie, brumrash, apo kanë bar kafe.

Prej datës 1 nëntor, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës do të monitorojnë në terren furrat e bukës për evidentimin e çdo sjelljeje abuzuese në shkelje të ligjit "Për mbrojtjen e Konkurrencës". Ky ligj ndalon të gjitha marrëveshjet të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që

çaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.

Në njoftimin e publikuar, Autoriteti i Konkurrencës thekson se shkelja e ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, në

UNIDO DHE UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS BASHKOHEN PËR TË MODERNIZUAR AGROBIZNESIN SHQIPTAR ME PLATFORMËN DIXHITALE

TAKIME NË SHKODËR DHE KORÇË PËR KRIJIMIN E GVV: NXITJA E BASHKËPUNIMIT MES AKTORËVE LOKALË SI KATALIZATORË PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

UNIDO vjen në ndihmë të Shqipërisë në forcimin e infrastrukturës së cilësisë dhe për përmbushjen e kërkesave të standardeve ndërkombëtare për qëndrueshmëri si dhe duke mbështetur e promovuar zhvillimin afatgjatë të komuniteteve, në kuadër të Programit Global për Cilësinë dhe Standardeve (GQSP) me mbështetje nga SECO

UNIDO dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës bashkohen për të modernizuar agrobiznesin shqiptar me platformën dixhitale

Në një hap të rëndësishëm për bujqësinë dhe agrobiznesin shqiptar, ekipi i UNIDO-s u takua së fundmi me rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), përfaqësues të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe ekspertë ndërkombëtarë në fushën e dixhitalizimit dhe inovacionit. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i një platforme dixhitale dhe aplikacioni mobil inovativ që synon të modernizojë sektorin e bimëve aromatike dhe mjekësore (BAM) në Shqipëri.

Platforma Dixhitale dhe Aplikacioni Mobil, të zhvilluar

shoqërinë civile.

Në përputhje me këtë angazhim, takimet e njëpasnjëshme që po zhvillohen në Shkodër dhe Korçë janë një hap i rëndësishëm për krijimin e këtyre grupeve dhe për fuqizimin e bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm lokalë. Ato synojnë krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim, duke inkurajuar një qasje të integruar dhe të qëndrueshme sipas metodologjisë LEADER të Bashkimit Evropian (BE). Këto takime ndihmojnë në ngritjen e një infrastrukture cilësore, e cila mbështet rritjen e kapaciteteve lokale dhe përafrimin me standardet e BE-së, duke siguruar përfitime të drejtpërdrejta për komunitetet rurale dhe për ekonominë e vendit.

Këto takime promovojnë përfshirjen aktive të aktorëve lokalë dhe krijojnë mundësi për dialog ndërmjet sektorëve të ndryshëm. Ato ndihmojnë në identifikimin e nevojave

Evropian, këto takime po luajnë një rol vendimtar në ngritjen e një strukture solide për zhvillimin rajonal, që adreson nevojat dhe potencialet e veçanta të komuniteteve rurale në Shkodër dhe Korçë. Kjo qasje përqendrohet në krijimin e një platforme gjithëpërfshirëse ku çdo aktor lokal, përfshirë fermerët, prodhuesit e mjaltit, prodhuesit e vajit të ullirit, përpunuesit e bimëve mjekësore dhe aromatike, si dhe përfaqësues të bizneseve të tjera të bujqësisë, ka një zë të fortë dhe të përfaqësuar në vendimmarrjen për zhvillimin e rajonit të tij. LEADER nxit bashkëpunimin ndërmjet sektorëve dhe siguron që çdo vendim të marrë formën e një strategjie të integruar që pasqyron vlerat lokale, kapacitetet ekonomike dhe aspiratat e komunitetit.

GVV-të në Shkodër dhe Korçë shërbejnë si modele të qasjes së decentralizuar, ku vendimet për zhvillimin ekonomik dhe social merren në nivel lokal, duke fuqizuar kështu jo vetëm strukturën e qeverisjes vendore, por edhe lidhjet e ngushta mes sektorit privat, shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Duke krijuar mundësi të reja për investime në infrastrukturë rurale, përmirësimin e kushteve të jetesës, dhe zhvillimin e produkteve lokale me vlerë të shtuar, GVV-të kontribuojnë në një ekonomi të qëndrueshme dhe të diversifikuar që reflekton qëllimet e politikave evropiane për zhvillim rajonal dhe rural. Këto përpjekje mundësojnë që komunitetet të ndihen pjesë integrale e zhvillimit të qëndrueshëm, duke kontribuar në uljen e migrimit rural dhe përforcimin e stabilitetit ekonomik të këtyre rajoneve për një të ardhme të sigurt dhe të begatë.

Kontributi i këtyre takimeve është i rëndësishëm për krijimin e një kuadri të përbashkët për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal, pasi ato krijojnë mundësi për dialog ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe forcojnë bashkëpunimin ndër-institucional. Përmes këtyre bashkëpunimeve, GVV-të mund të promovojnë projekte që adresojnë sfida të ndryshme lokale, si përmirësimi i infrastrukturës, zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe nxitja e sipërmarrjes. Ky bashkëpunim kontribuon në një model zhvillimi që mbështetet në burimet e rajonit dhe përqendrohet në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit lokal, duke e kthyer çdo rajon në një forcë aktive dhe të qëndrueshme për zhvillim.

Ndërtimi i një platforme gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese

Këto takime luajnë një rol themelor në krijimin e një platforme gjithëpërfshirëse që bashkon aktorët kryesorë të komunitetit për planifikimin dhe drejtimin e projekteve lokale. Ky proces i integruar synon që çdo vendimarrje të pasqyrojë në mënyrë të saktë interesat dhe nevojat specifike të rajonit, duke siguruar që çdo aktor të ketë një rol aktiv dhe ndikues në zhvillimin rajonal.

Në Shkodër, Grupi Vendor i Veprimit Rajonal GVV "Drini-Buna" përfshin bashkitë e Shkodrës, Vau i Dejës, Koplik, Pukë dhe Fushë-Arrëz, duke mbledhur përfaqësues nga fusha të ndryshme për të formësuar një vizion të përbashkët për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përmes angazhimit të gjerë, që përfshin jo vetëm përfaqësuesit e institucioneve lokale, por edhe akademinë dhe sektorin privat, ky grup synon të ndërtojë një kornizë strategjike të bazuar në ekspertizën dhe përvojën e të gjithë



nga UNIDO në kuadër të Programit Global për Cilësinë dhe Standardeve (GQSP) me mbështetje nga SECO, do të menaxhohen nga UBT. Kjo iniciativë synon të nxjerrë në pah inovacionin dhe të rrisë konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) në sektorin e BAM-ve, duke ofruar mundësi për rritjen e aksesit në të dhëna, praktika të qëndrueshme dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare.

E projektuar posaçërisht për të mbështetur fermerët dhe bizneset në zonat rurale, kjo platformë do t'i ndihmojë aktorët kryesorë të sektorit të fitojnë aftësi të reja dhe të rrisin kapacitetin e tyre inovativ për të përmbushur kërkesat e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kjo iniciativë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një agrobiznesi të qëndrueshëm dhe konkurrues, duke integruar teknologjinë me traditën për të siguruar një të ardhme më të mirë për agrobiznesin shqiptar. Bashkëpunimi mes Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe UNIDO-s është një shembull frymëzues për avancimin e bujqësisë në Shqipëri, duke theksuar rëndësinë e inovacionit dhe dixhitalizimit në zhvillimin e këtij sektori kyç për ekonominë e vendit.

Grupet Vendore të Veprimit si katalizatorë për zhvillimin e qëndrueshëm në rajonet Shqiptare

UNIDO vjen në ndihmë të Shqipërisë në forcimin e infrastrukturës së cilësisë dhe për përmbushjen e kërkesave të standardeve ndërkombëtare për qëndrueshmëri, si edhe duke mbështetur zhvillimin afatgjatë të komuniteteve, duke promovuar një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë për komunitetet, në kuadër të Programit Global për Cilësinë dhe Standardeve (GQSP) me mbështetje nga SECO. Një element kyç në këtë proces janë Grupet Vendore të Veprimit (GVV), të cilat krijojnë një platformë gjithëpërfshirëse për angazhimin e aktorëve të rëndësishëm të rajonit, përfshirë përfaqësues të qeverisjes lokale, biznese, akademikë dhe



dhe potencialele specifike të çdo rajoni, duke u siguruar që vendimet e marra të reflektojnë realitetin lokal dhe të kontribuojnë në një ekonomi të qëndrueshme. Në këtë kuadër, GVV-të shërbejnë si modele që fuqizojnë strukturën e qeverisjes vendore dhe lidhjet mes sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Rëndësia e këtyre iniciativave shtrihet përtej thjesht organizimit të takimeve; ato krijojnë një kuadër bashkëpunimi dhe përfshirjeje që mundëson zhvillimin e projekteve që adresojnë sfida lokale, përmirësojnë infrastrukturën dhe nxisin sipërmarrjen. Me fokus në sektorët kryesorë të bujqësisë dhe zhvillimin e produkteve lokale, GVV-të kontribuojnë në stabilitetin ekonomik dhe sociale të rajoneve, duke promovuar një rritje të qëndrueshme dhe përfitime afatgjata për komunitetet. Kështu, Grupet Vendore të Veprimit shndërrohen në katalizatorë të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në Shqipëri.

Rëndësia e këtyre takimeve për procesin e krijimit të GVV-ve dhe kontributi i tyre në zhvillimin rajonal

Takimet e njëpasnjëshme që po mbahen në Shkodër dhe Korçë për krijimin dhe forcimin e GVV, synojnë përmirësimin e zhvillimit rajonal përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të përbashkët. Këto takime janë të strukturuar mbi parimet e metodologjisë LEADER të Bashkimit Evropian, që promovon përfshirjen aktive të aktorëve lokalë – nga përfaqësuesit e bashkive dhe bizneset, deri tek përfaqësuesit e sektorit akademik dhe shoqërisë civile. Pjesëmarrja e gjerë në vendimmarrje garanton që secili rajon të ndërtojë një model të qëndrueshëm zhvillimi që përshtatet me nevojat e tij specifike, duke respektuar gjithashtu përvojat dhe kapacitetet lokale.

Përmes qasjes LEADER, e mbështetur nga Bashkimi

FINANCIM

Skema e Investimeve, AZHBR përmbyll ditët informuese me fermerët

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) zhvilloi në Lushnjë aktivitetin përmbyllës të 14 ditëve informuese për Skemën Kombëtare të Investimeve 2024, me fermerë dhe sipërmarrës që operojnë në sektorin e bujqësisë, në 12 qarqe të vendit.

AZHBR bëri të ditur se, fermerët patën mundësinë të informohen mbi kriteret dhe përfitimet që ofron skema për investimet në bujqësi dhe akuakulturë.

Skema Kombëtare e Investimeve me fond prej 1,5 miliardë lekë nis këtë vit me një buxhet 500 milionë lekë, e miratuar në Aktin Normativ të Qeverisë, por do të vijojë të paguhet dhe për gjatë vitit që vjen.

Skema ka si qëllim të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor

duke ndihmuar fermerët për ndërtimin e serrave të reja diellore, instalimin e rrjetave antibreshër, ndërtimin e stallave, mekanizimin e bujqësisë dhe

Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe aplikantët e rregullt mund të fillojnë edhe këtë vit menjëherë nga pagesat me 30% të investimit grant.



mbështetje për akuakulturën. Aplikimet për këtë skemë kanë nisur më 1 tetor online në

AZHBR njofton se aplikimet janë të hapura deri më 8 nëntor.

Bashkëpunim me BERZH-in për përgatitjen e sipërmarrjeve të vogla për tregjet evropiane

Ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj si dhe drejtuesja e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Ekaterina Solovova nënshkruan sot një memorandum mirëkuptimi.

Ministrja Ibrahimaj bëri të ditur se memorandumit i mirëkuptimit mes Ministrisë së Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit dhe BERZH-it është një hap i rëndësishëm, i cili përforcon vullnetin për të bashkëpunuar në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare në përgatitjen

ajo.

Ky program trajnimi i mbështetur nga EU-funded Enterprise Development and Innovation Facility (EDIF) do të zhvillohet përmes tetë workshop-eve të dedikuara, të cilat janë pjesë e një strategjie më të gjerë për të fuqizuar NVM-të dhe për t'i pajisur ato me njohuritë dhe instrumentet e nevojshme për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare. Seria e trajnimeve mbi SMP do të fokusohet në rritjen e kapaciteteve të NVM-ve shqiptare dhe në përgatitjen e tyre për sfidat e tregjeve rajonale dhe

të Europës. NVM-të shqiptare duhet të përgatiten për një integrim të suksesshëm në tregun e brendshëm të BE-së paraanëtarësimit të vendit në BE. Kjo është arsyeja pse BE po hap "Programin e Tregut të Brendshëm të BE-së" për NVM-të shqiptare", tha ai.

Ekaterina Solovova, drejtoresha e BERZH-it në Shqipëri, theksoi rolin e rëndësishëm që BERZH do të luajë në këtë proces.

"Ne jemi krenarë të ndihmojmë SME-të shqiptare për t'u përgatitur më mirë për Tregun e Përbashkët të



e tyre për tregjet evropiane, me anë të implementimit të një serie me 8 seminare me njohuri për programet e tregut të përbashkët evropian.

"Partneriteti me BERZH-in është thelbësor për Shqipërinë, pasi ofron mbështetje financiare dhe ekspertizë që ndihmon në realizimin e projekteve të rëndësishme për rritjen ekonomike dhe integrimin në tregjet ndërkombëtare. Kjo nismë do të kontribuojë në forcimin e lidhjeve tona me BE-në dhe krijimin e mundësive të reja për bizneset shqiptare", tha

evropiane.

Përfaqësues të lartë nga institucionet ndërkombëtare dhe shqiptare ndanë pikëpamjet e tyre mbi rëndësinë e këtij programi.

Kreu i Bashkëpunimit në Delegacionin e BE-së në Shqipëri, Hubert Perr shprehu mbështetjen e plotë të Bashkimit Evropian për zhvillimin e NVM-ve.

"Tregu i brendshëm i BE-së është një nga arritjet më të mëdha të Unionit. Ai stimulon konkurrencën, rritjen dhe inovacionin, si dhe drejton tranzicionet e gjelbra dhe digjitale

BE nëpërmjet një serie seminaresh që adresojnë nevojat specifike të bizneseve lokale. BERZH ndihmon në rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve Shqiptare përmes asistencës teknike, shërbimeve të konsulentëve dhe linjave të dedikuara të financimit".

Ndërsa Ardian Kamenica, drejtor i departamentit të Politikave dhe Integritimit Evropian, e përshkroi programin si një mundësi për NVM-të shqiptare për të përforcuar kapacitetet e tyre dhe për të përmbushur standardet evropiane.

VanHorn: Një klimë pozitive biznesi, thelbësore për rritjen e investimeve amerikane

E Ngarkuara me Punë në ambasadën e Shteteve të Bashkuara

kane të Tregtisë (AmCham).

Në një postim në rrjetet so-

ligjit, procesin e integritimit në BE dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Dhomës dhe Ambasadës për të përmirësuar mjedisin e biznesit për investime të brendshme dhe të huaja.

VanHorn vlerësoi përpjekjet e Dhomës për lobim në përmirësimin e kuadrit rregullator dhe nxitjen për një proces konsultimi publik transparent dhe efektiv mbi legjislacionin që lidhet me biznesin.

VanHorn premtoi mbështetje të vazhdueshme nga ambasada për përpjekjet e AmCham në nxitjen e një klime pozitive investimi, e cila është një kusht thelbësor për rritjen e investimeve amerikane në Shqipëri.



të Amerikës, Nancy VanHorn pati një mëngjes pune me Bordin Drejtues të Dhomës Ameri-

ciale, ambasada e SHBA-së, bën të ditur se ata diskutuan për mjedisin e biznesit, sundimin e

Përfaqësues të 22 vendeve në samitin parlamentar "Rruga drejt sistemeve gjithëpërfshirëse dhe fleksible agroushqimore"

Kuvendi i Shqipërisë në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë

në vendin tonë, nga Arben Pëllumbi, kryetar i komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe dy depu-

ropën dhe Azinë Qendrore, dhe Martin Chungong, Sekretari i Përgjithshëm i Unionit Ndërparlamentar.

Në panelet e ndryshme përgjatë dy ditëve, u diskutua dhe u shkëmben mendime mbi sfidat me të cilat përballen transformimi aktual i sistemeve ushqimore; perspektivat mbi sigurinë ushqimore; politikat kombëtare për transformimin e sistemeve agroushqimore; roli i parlamenteve dhe iniciativave legjislative për të adresuar sfidat me të cilat ballafaqohen sistemet agroushqimore; bujqësia digjitale dhe zhvillimi i zinxhirit të vlerës; nxitja e një mjedisi të favorshëm për investime të përgjegjshme në bujqësi, etj.

Gjatë diskutimeve u theksua rëndësia e ndërlidhjes mes komisioneve parlamentare, për të siguruar që buxhetet përkatëse të jenë përgjegjëse për objektivat e parashikuara, si dhe roli i parlamenteve, rrjeteve parlamentare dhe anëtarëve të parlamenteve në mbështetjen dhe zbatimin e nismave të qëndrueshme të sistemeve agroushqimore.



(FAO) kanë përmblyllur me sukses, Samitin Parlamentar "Rruga drejt sistemeve gjithëpërfshirëse dhe fleksible agro-ushqimore", në të cilin morën pjesë kryetarë të komisioneve parlamentare për bujqësinë dhe ushqimin të Europës dhe Azisë Qendrore.

Kuvendi i Shqipërisë përfaqësohej në këtë samit, i pari i këtij niveli organizuar

tetët e këtij komisioni: Edona Bilali dhe Fadil Nasufi. Në samit morën pjesë përfaqësues të 22 vendeve, duke përfshirë rëndësinë dhe angazhimin për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme.

Samiti u përshëndet nga kryetarja e Kuvendit, Elisa Spiropali, si edhe nga Raimund Jehle, Drejtues i Programit Rajonal, Zyra Rajonale e FAO-s për Ev-

AZHBR: Skema Kombëtare financon 59,621 fermerë

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural vijon disburimin e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2024.

AZHBR, bën të ditur se, deri më sot janë 59,621 fermerë të financuar me një fond prej 2,18 Miliard lekësh, ndërkohë po vijon intensivisht procesi për kryerjen e pagesave për fermerët e tjerë.

Në Skemën Kombëtare 2024 ofrohet mbështetje për: tufën bazë të matrikulluar (gjedhë dhe të imta), bletarinë, fermat organike, certifikimi Global GAP,

fara-fidanë dhe inute të tjera, bimët mjekësore-aromatike, si edhe mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

Qëllimi i këtyre masave është ulja e kostove për fermerët dhe rritja e rendimentit të prodhimit vendas.



INFORMACIONE

Krijohet regjistri për kthimin e garancive shtetërore

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për krijimin e regjistrit për kthimin e garancive shtetërore për mbajtjen, arkivimin dhe përditësimin e të dhënave të garancive e mbledhjen e të gjithë dokumentacionit dhe raportimeve të huadhënësve.

Sipas këtij vendimi, regjistri për kthimin e garancive shtetërore, si bazë të dhënash, funksionon, administrohet dhe ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave, në përputhje me rregullat e legjislativonit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

Të dhënat që përmban regjistri për kthimin e garancive shtetërore ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore.

Në të dhënat parësore për menaxhimin e garancive shtetërore do të konsiderohen përfshihen kodi i identifikimit; produkti; përshkrim i vepërimit; data e pagesës; shuma e disburuar; statusi i kështit të principalit; data e shlyerjes së pagesës; principalit; përçindja e mbulimit të principalit; interesi dhe masa e mbulimit të interesit nga garancia; stoku; dokumentacioni në formë

PDF-je; të dhëna lidhur me pasuritë e lëna si kolateral apo të sekuestruar, si dhe kthimet e garancisë nga huamarrësit.

Në të dhëna dytësore për

organizimit të saj; të dhënat e identifikimit të themeluesve; të dhënat për selinë/vendndodhjen e biznesit apo për administratort; të dhënat lidhur me pasuritë



menaxhimin e garancive shtetërore përfshihen të dhënat për subjektin/personin fizik ose juridik; NIPT-i; të dhënat për gjeneralitetet e individit (për personat fizikë, dorëzanësit apo administratorët e subjektit); numrin personal i identifikimit (ID) të subjektit apo të personit fizik; të dhënat e regjistrimit tregtar për datën e regjistrimit të subjektit, emrin e subjektit/shoqërisë tregtare, numrin unik të identifikimit të subjektit, llojin e shoqërisë tregtare (formën e

e luajtshme dhe të paluajtshme; të dhënat mbi statusin e kredisë në bankat e nivelit të dytë, si dhe të dhënat për statusin e pagesës së sigurimeve shoqërore.

Administrator teknik i regjistrimit është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ndërkohë pronar me të drejta dhe përgjegjësi të plota për të dhënat që ruhen, administrohen dhe përpunohen në regjister është Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer.

Denaj takim me ambasadorën hungareze: Forcimi i marrëdhënieve në agroturizëm dhe agrobiznes

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj priti në një takim ambasadorën e Hungarisë, Martina Kasnyik dhe Sekretaren e parë dhe Atashe për Ekonominë dhe Tregtinë, Katalin Beszteri.

Gjatë takimit Denaj, Kasnyik dhe Beszteri biseduan për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e agroturizmit dhe agrobiznesit.

Denaj bëri të ditur se “ky takim produktiv vjen pas një vizite të suksesshme në Hungari, ku nënshkruam Memorandumin e Mirëkuptimit për bashkëpunimin bujqësor. Biseduam për forcimin e mar-



rëdhënieve tona dypalëshe, me fokus në asistencën teknike për Shqipërinë drejt integritetit në Bashkimin Europian,

shkëmbimet institucionale dhe mundësitë për zhvillimin e agroturizmit dhe agrobiznesit”, tha Denaj.

Kote: Drejt finalizimit kadastra e verës, mbulon 7 513 ha vreshta

Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

dhe ekspertë nga mbarë bota për zhvillimet më të fundit

së vazhdueshme të qeverisë shqiptare ka nisur puna për digjitalizimin e sektorit bujqësor.

“Po finalizojmë kadastrën e verës, e cila mbulon 7513 ha vreshta dhe 75 kantina vere, si dhe kadastrën e ullirit që tashmë përfshin 40% të ullishteve të vendit. Duke përdorur informacionin satelitor, do të kemi përditësime të shpeshta dhe të sakta të këtyre të dhënave”, tha ai.

Njëkohësisht, ai theksoi se po përditësohet edhe Portali i Fermerit, që ofron informacione mbi tregjet dhe çmimet për mbi 40 produkte, duke rritur qasjen e fermerëve në tregje të reja dhe sistemin LIMS për gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore.



Dhimitër Kote mori pjesë në konferencën ndërkombëtare “nanoBallkan 2024”, që bashkoi në Tiranë 250 shkencëtarë

në nanoshkencë dhe nanoteknologji.

Në fjalën e tij, Kote bëri të ditur se përmes mbështetjes

Rama: Masa drastike për çdo biznes të vogël

Kryeministri Edi Rama deklaroi se “ne nuk e pranojmë dot dhe do të marrim masa drastike për çdo biznes të vogël që nuk paguan sigurimet shoqërore deri në mbyllje të aktivitetit”.

Gjatë takimit me strukturat tatimore për prezantimin e planit për luftën ndaj informalitetit Rama tha se “biznesit të vogël i kemi kërkuar vetëm që të paguajë sigurime shoqërore dhe shëndetësore, asnjë

atë që ishte përpara teje. Ky është zinxhiri, prandaj autografitjen ne nuk e pranojmë dot”, nënvizoi Rama.

Kreu i qeverisë u shpreh se “të gjitha të tjerat mund t’i diskutojmë, edhe taksat mund të diskutohen në kuptimin, ka një sistem në Republikën e Shqipërisë dhe ju e dini mirë, të marrëshjeve, jo debia, jo “kam ca borxhe, hajde bëjmë një ristrukturim” dhe e ka, është me ligj, që do të thotë

këtë ne po e studiojmë për të mos e përdorur si një pengesë për formalizimin, pra për të mos i vënë përpara bizneseve si gurë në rrugë, por fillimisht duke ia lënë bizneseve topin tani që kur të bëjnë atë deklarimin e pagave, ta bëjnë si praninë të këtij kushti moral, edhe si praninë të këtij detyrimi ligjor dhe ju lutem mos na e bëjnë si ftesë për inspektim, mos na e bëjnë si ftesë për hetim, mos na e bëjnë si sfidë për dënim”, tha Rama.

Ju lutem, shtoi Rama, mos provokoni më shtetin me deklarime që janë ofenduese për inteligjencën e njeriut.

“Nuk mundet dot të ngresh pallate e të sheshesh apartamente me mijëra euro dhe në kushtet e një tregu pune ku të gjithë ndërtesit thonë “aman, vetëm punëtorë më duhen, s’ka rëndësi sa i paguaj” dhe shtetit ti t’i thuash që këta i paguan me 60 mijë lekë të reja? Këtë nuk mundet, nuk mundet”, tha Rama.

Duke iu drejtuar sipërmarrësve Rama tha se “ju lutem, merreni shumë seriozisht mesazhin që ju ka ardhur nga drejtorja e Tatimeve sepse është vetëm fillimi i një ndërveprimi mes nesh dhe jush që ne duam të jetë sa më konstruktiv dhe sa më çlirues për shpirtrat e të gjithëve në raport me pensionistët, por që jemi të gatshëm ta bëjmë edhe një ndërveprim dramatik për ata që nuk do ta marrin seriozisht”.



taksë dhe mbi të gjitha biznesi i vogël që është i vetëpunësuar, ia paguan vetes së vet, pra paguan për pensionin e vet”.

“Kjo quhet autografitje, domethënë të vjedhësh veten tënde. Problemi është që këto paratë që sot nuk janë të tuat, këto para do t’i marrë pensionisti. Kur të dalësh ti në pension, atëherë do ta kuptosh çfarë i ke bërë vetes se ai tjetri që do të jetë në punë, nuk t’i jep dot ty ato sepse ti nuk ke paguar për

taksat mund të diskutohen në marrëdhënie me institucionet e të ardhurave”.

“Republika e Shqipërisë dhe asnjë republikë tjetër nuk e ka një të tillë për sigurimet shoqërore dhe kemi sot aktualisht, një numër të konsiderueshëm biznesesh që figurojnë debitorë ndaj pensionistëve. E kanë aty, debitorë. Nuk e ka Republika e Shqipërisë këtë mundësi që t’i thuash “hajde ta bëjmë me këste, të falim atë”, por edhe

“Rruga e Gështenjës”, akses më i madh për vizitorët në masivet e Tropojës

Festa e Gështenjës, një traditë që kujton rëndësinë e

turistike për vizitorët në zonën më të madhe të gështenjës në

Të gjithë duhet të kenë akses në ushqime të mjaftueshme ushqyese të përbalueshme të sigurta dhe të qëndrueshme.

Zona malore e Tropojës, ka mbi 2000 hektarë masiv pyjor gështenjash dhe 70% e banorëve të zonës sigurojnë të ardhura ekonomike nga ky produkt.

Projekti “Zhvillimi i qëndrueshëm i zinxhirit të vlerës së gështenjës” do të zgjasë deri në vitin 2025. Nisma synon rigjallërimin e zinxhirit të vlerës së gështenjës, duke përfshirë prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e gështenjës, me në fokus zgjerimin e sipërfaqeve



produkteve sezonale dhe vendore, mblodhi së bashku në Tropojë, fermerë, partnerë dhe aktorë të linjës, për të folur për ushqimet, duke nënvizuar nevojën për akses më të madh në një shumëllojshmëri ushqimesh ushqyese, të sigurta dhe të qëndrueshme.

Në një njoftim për media, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bën të ditur se, në partneritet me FAO-n, po mbështet zinxhirin e qëndrueshëm të vlerës së gështenjës.

Një nga aktivitetet e projektit është promovimi i Rrugës së Gështenjës me synimin rritjen dhe mundësinë e atraksioneve



Shqipëri, Tropojë.

Aktiviteti vjen në kuadër edhe të Ditës Botërore të Ushqimit.

të kultivuara dhe pozicionimin e produkteve të gështenjës në tregun rajonal.

INFORMACIONE

Forumi i biznesit Shqipëri-Greqi, ushqimi, ndërtimi, turizmi dhe energjia sektorë kyç të bashkëpunimit

Ushqimi, ndërtimi, turizmi dhe energjia janë këto sektorët e ekonomisë shqiptare të cilët po shihen me interes nga ana e sipërmarrjeve greke.

Forumit e biznesit Shqipëri-Greqi, të organizuar nga Dhomat e Tregtisë dhe industrisë Tiranë dhe Athinë e përshëndeti Ministri i Ekonomisë, Blendi Goxhe i cili theksoi roli e vendit fqinj si një model për rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE-së.

Kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Athinë, Sofia Efraimoglou Kounenaki theksoi rolin që luan integrimi i vendit në funksion të bashkëpunimit ekonomik.

"Perspektiva e Shqipërisë në Bashkimin Europin dhe nevojat e bashkëpunimit rajonal në hapësirën e Ballkanit Perëndimor po krijojnë mundësi të reja midis bizneseve shqiptare dhe greke.

Afërsia jonë gjeografike dhe fakti që një numër i madh i qytetareve e njohin gjuhën greke krijojnë një mjedis të frytshëm për shfrytëzimin e

Greqia është një ndër partnerët më të rëndësishëm ekonomik të vendit tonë referuar volumit të shkëmbimeve tregtare, por edhe investimeve



këtyre mundësive", tha ai.

Kreu i Dhomës së Tregtisë Tiranë, Nikolin Jaka u bëri thirrje sipërmarrësve grekë të zgjerojnë investimet e tyre në Shqipëri.

direkte.

Bizneset greke ndër vite ka zhvilluar aktivitetin e tyre në industri si telekomunikacioni, bankat, energjia dhe shëndetësia.

Prodhim bujqësor pa pesticide - Zv.kryeministrja Balluku dhe ministrja Denaj bashkëbisedojnë me fermerët

Zv/kryeministrja, njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku dhe ministrja e Bujqësisë, Anila Denaj, kryen një inspektim në Qendrën e Transferimit Teknologjik

ja që nuk është e shëndetshme.

Përsa i përket mënyrës që ju e ndani të gjithë laboratorin në terren që e ndani me pjesën tjetër të fermerëve, si është mentaliteti i fermerëve janë të

për të investuar në këto lloj teknikash bujqësore.

Edhe regjistrimi i fermave që përdornin këto aplikime nga asistencat teknike e Ambasadës zvicerane etj është dhe për të ndërlidhur bizneset me njëri-tjetrin. Si kjo qendër, kemi 5 qendra në të gjithë Shqipërinë. Janë qendra që krijojnë mundësinë e implementimit të inovacionit, metodave të reja për sektorë të ndryshëm të zhvillimit ekonomik bujqësor. Kemi tokën dhe analizat e tokës ndodhen në Fushë Krujë, aty jemi duke menduar investimin në laboratorë bashkëkohorë, në mënyrë që edhe koha e procesimit për analizën e tokës të bëhet sa më shpejt. Ajo që ka nevojë kjo qendër është rritja e investimit në infrastrukturë jemi duke parë dhe me Agjencinë e Inovacionit mundësinë e serrave modern të vitit 2030.

Sipas ministres Denaj, në Fushë Krujë po mendohet të investohet në një laborator bashkëkohor në mënyrë që procesimi i analizës së tokës të bëhet sa më shpejt.



Bujqësor në Lushnjë. Në këtë qendër të gjitha produktet bujqësore prodhohen pa pesticide.

Me pak fjalë i heqim frikën fermerit dhe e bëjmë të kuptojë që edhe nëse nuk përdor pesticide produkti rritet dhe madje më i shëndetshëm.

Do shikojmë pjesën që është me pleh joorganik. Duket gjith-

kënaqur, ju arrini të ndikoni?

Në të njëjtën serrë eksperimentale ju keni të dyja llojet se si funksion me distancën e duhur, me plehun organik apo se si funksion ndryshe me distancën më të ngushtë dhe me plehun kimik, kjo është tregues që i bindni me fakte.

Nga ana e saj, ministrja Denaj u bëri thirrje fermerëve

UNIDO

Takime në Shkodër dhe Korçë për Krijimin e GVV: Nxitja e Bashkëpunimit mes Aktorëve Lokalë si Katalizatorë për Zhvillimin e Qëndrueshëm

(Vijon nga faqja 3)

aktorëve të përfshirë. Kjo strukturë ndihmon në garantimin e vendimeve të mirëinformuara, që i përgjigjen realiteteve lokale dhe promovojnë përfshirjen e çdo sektori në procesin e zhvillimit.

Në Korçë, në takimin e GVV janë përfshin bashkitë e Korçës, Pustecit, Devollit, Kolonjës, Maliqit dhe Pogradecit dhe fokusohet në krijimin e një strukture bashkëpunimi që mbështet zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm ekonomik të rajonit. Përfshirja e këtyre aktorëve nga të gjitha fushat krijon një bazë të fortë për bashkëpunim dhe e bën platformën të qëndrueshme në kohë. Ndërsa çdo vendim bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse dhe një qasje të bashkërenduar, procesi siguron që projektet dhe strategjitë e zhvillimit të jenë të mbështetura dhe të miratuara nga të gjitha palët e përfshira. Kjo platformë jo vetëm që ndihmon në zgjidhjen e sfidave aktuale, por edhe forcon lidhjet ndërmjet sektorëve dhe krijon kushte për një zhvillim të qëndrueshëm dhe përfitime afatgjata për komunitetet lokale.

Prioritetet e GVV-ve në kontekstin e zhvillimit rajonal dhe qasjes LEADER

Prioritetet e Grupeve Vendore të Veprimit janë të përqendruara në zhvillimin e sektorëve kyç të bujqësisë, përfshirë jo vetëm bimët mjekësore dhe aromatike, por gjithashtu prodhimin e mjaltit, vajit të ullirit, dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm për ekonominë lokale. Takimet e njëpasnjëshme mes aktorëve lokalë ndihmojnë në përcaktimin e objektivave specifike për çdo sektor, duke synuar fuqizimin e komunitetit lokal dhe orientimin drejt një zhvillimi të integruar dhe të qëndrueshëm. Përmes qasjes LEADER, GVV-të përfshijnë fermerët, bizneset lokale dhe shoqërinë civile në procesin e vendimmarrjes, duke krijuar një strategji të bazuar në burimet dhe potencialet lokale që kontribuon në një ekonomi më të qëndrueshme dhe me ndikim afatgjatë.

Një prioritet i rëndësishëm është zhvillimi i sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike, duke promovuar praktikën bujqësore të qëndrueshme dhe përmirësuar

aksesin në tregjet ndërkombëtare për produktet e rajonit. Gjithashtu, GVV-ja ka përqendruar vëmendjen në zhvillimin e sektorëve të tjerë të bujqësisë si prodhimi i mjaltit dhe vajit të ullirit, që përfaqësojnë traditën dhe potencialin ekonomik të zonës. Gjithashtu, promovimi i turizmit rural mbetet një prioritet kryesor për të dy rajonet, duke synuar të tërheqë vizitorë të rinj dhe të ruajë trashëgiminë kulturore, ndërsa krijon mundësi të reja ekonomike për komunitetin lokal.

Ndikimi ekonomik i krijimit të GVV-ve në Rajonet e Shkodrës dhe Korçës

Përfshirja e fermerëve, prodhuesve lokalë dhe aktorëve të tjerë në procesin e vendimmarrjes përmes GVV-ve ka krijuar një platformë të fuqishme për të nxitur inovacionin dhe për të përqafuar teknologjitë bashkëkohore në sektorët kryesorë të bujqësisë. Duke bashkëpunuar në sektorë të ndryshme, GVV-të rrisin jo vetëm mundësitë për përfitime të qëndrueshme ekonomike, por gjithashtu u japin fermerëve dhe bizneseve të vogla një rol të drejtpërdrejtë në hartimin e strategjive për zhvillim afatgjatë. Kjo përfshirje thekson rëndësinë e njohjes dhe shfrytëzimit të përvojave dhe kapaciteteve lokale, duke siguruar që secili rajon të zhvillojë një model ekonomik të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për nevojat e tij specifike.

Ky model i ri zhvillimi forcon pavarësinë ekonomike të rajoneve dhe ndihmon në uljen e varësisë nga qendrat urbane, duke i dhënë frymëmarrje komuniteteve rurale dhe duke frenuar migrimin nga fshati drejt qyteteve. Përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit të të ardhurave të qëndrueshme, GVV-të jo vetëm që ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së banorëve, por edhe në fuqizimin e qëndrueshëm të ekonomisë lokale. Duke mbështetur një qasje të decentralizuar dhe gjithëpërfshirëse, GVV-të kontribuojnë në stabilitetin ekonomik të rajonit dhe promovojnë një rritje të qëndrueshme të të ardhurave të bazuar në potencialin dhe burimet e rajoneve. Ky proces mundëson zhvillimin e komuniteteve të qën-

drueshme dhe reziliente, të afta për t'u përballur me sfidat e zhvillimit nëpërmjet burimeve të tyre të brendshme dhe bashkëpunimit ndërmjet rajoneve, duke ndërtuar kështu një të ardhme të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha shtresat e komunitetit.

Në përfundim, këto takime shërbejnë si themel për një strukturë të re bashkëpunimi dhe përfshirjeje që tejkalon funksionin e një forumi diskutimi, duke ofruar një platformë konkrete dhe të qëndrueshme për të fuqizuar komunitetet dhe për të orientuar zhvillimin rajonal drejt qëllimeve afatgjata dhe të qëndrueshme. Duke vënë në zbatim qasjen LEADER të mbështetur nga Bashkimi Evropian, GVV-të ndihmojnë në krijimin e një modeli unik dhe transformues për Shqipërinë rurale, që ndërthur nevojat lokale me standardet dhe përparësitë e BE-së për zhvillim të qëndrueshëm. Ky model fuqizon aktorët lokalë që të marrin pjesë aktive në vendimmarrje dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike, duke përdorur burimet dhe kapacitetet e tyre në mënyrë që të ndihmojnë në zhvillimin e një ekonomie të diversifikuar dhe të qëndrueshme.

Përtej ndikimit të menjëhershëm ekonomik, kjo qasje ndihmon në stabilizimin social të rajoneve, në uljen e migrimit dhe në përmirësimin e cilësisë së jetesës për brezat e ardhshme. GVV-të shtrijnë ndikimin e tyre përmes një modeli që nuk shërben vetëm për të adresuar sfidat aktuale, por edhe për të krijuar mundësi të reja dhe të qëndrueshme që i përshtaten veçanërisht nevojave të komuniteteve rurale. Kjo strukturë jo vetëm që sjell një ekonomi më të fuqizuar për zonat rurale të Shqipërisë, por përfaqëson gjithashtu një kontribut thelbësor në harmonizimin e politikave kombëtare me prioritetet dhe praktikën e Bashkimit Evropian për zhvillimin rural. Në këtë mënyrë, GVV-të nuk janë vetëm një mekanizëm mbështetës për zhvillim lokal, por edhe një shembull për politikën e ardhshme që mund të zbatohet praktika të ngjashme për të fuqizuar dhe integruar më mirë rajonet rurale në ekonominë kombëtare dhe atë evropiane, duke krijuar kështu një të ardhme më të begatë dhe të qëndrueshme për të gjithë Shqipërinë.

VAJI I ULLIRIT

Sa cilësor është vaji shqiptar i ullirit? - EVOO: Kemi lënë pas rajonin. Renditemi në vend të 28-të me 9 çmime të fituara

Shqipëria si pjesë e mesdheut ka një traditë mjaft të vjetër të prodhimit të ullirit dhe vajit të tij, por vitet e fundit ka marrë akoma më shumë vëmendje për shkak të potencialit që ka në ekonominë e vendit sa i përket të ardhurave që gjeneron.

Po ashtu, një rëndësi të veçantë i jepet edhe për shkak të vlerave që ka. Por si renditet vaji i ullirit ekstra i virgjër, i cili prodhohet në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera?

Renditja Botërore EVOO, e cila është krijuar për të promovuar për konsumatorët produktet më të vlerësuar në botë, ka ekzaminuar mostra të vajit të ullirit nga 37 vende prodhuese të ullirit ku mes tyre gjendet edhe vendi ynë.

Nga këto 37 shtete prodhuese të vajit të ullirit, Shqipëria renditet në vend të 28-të duke u vlerësuar me rreth 335 pikë për vitin 2023. Sipas të dhënave të raportit, Shqipëria ka 9 çmime të fituara sa i përket shijes dhe cilësisë së vajit të

ullirit dhe është rritur ndjeshëm në renditje krahasuar me vitet e mëparshme.

Në krye të renditjes për vitin 2023 vijon të qëndrojë Italia

Maltën, Malin e Zi, Rumaninë dhe Bullgarinë, e cila renditet e fundit.

Sipas të dhënave të "Institutit të Statistikave" në vitin



me vajin më të mirë të ullirit, duke grumbulluar 91,866 pikë dhe me 2,199 çmime të fituara. Në vend të dytë në botë renditet Spanja, ndjekur nga Turqia në vend të tretë, e cila ka spostuar Greqinë në vend të katërt për këtë vit.

Në renditjen botërore të EVOO-s, vaji i ullirit ekstra të virgjër me origjinë shqiptare ka lënë pas Bosnje Hercegovinën,

2023, u prodhuan 117 mijë tonë ullinj, duke shënuar rënie me 25.42%, krahasuar me një vit më parë. Varietetet e ullirit për vaj përbëjnë 87.25% të prodhimit gjithsej dhe varietetet e ullirit për tavolinë përfaqësojnë 12.75%. Përpos prodhimit të vajit "Made in Albania" një peshë të konsiderueshme zë edhe produkti i importit.

"Pritet cilësi më e mirë e vajit të ullirit" - Pedagogia Kyçyk: Çmimi do të variojë nga 1000-1100 lekë

Ndryshe nga një vit më parë, në tregun shqiptar nuk

tit, nuk është prekur prodhimi, por edhe cilësia e produktit.

sionin Box to Box, pedagogia, Onejda Kyçyk tha se kostot e shtuara si pasojë edhe e mungesës së fuqisë punëtore, do të ndikojnë në çmimin final, që do të variojë nga 1000 lekë-1100 lekë.

Teksa foli për masat mbështetëse, Kyçyk tha se duhen politika jo vetëm për të rigjeneruar sipërfaqet e mbjella me ullinj, por edhe për të shtuar dhe rritur sipërfaqet e reja. Me rëndësi sipas saj është edhe ruajtja e varietetit autokton.

Kujtojmë që një vit më parë fermerët dhe prodhuesit të vajit të ullirit u përballën me rënie të prodhimit, por edhe cilësisë, gjë që solli mungesa në treg



"PRITET CILËSI MË E MIRË E VAJIT TË ULLIRIT"
PEDAGOGIA KYÇYK: ÇMIMI DO TË VARIJË NGA 1000-1100 LEKË

do të ketë mungesë të vajit të ullirit. Pavarësisht kushteve jo shumë të favorshme të mo-

Por, çfarë pritet të ndodhë me çmimin?

Në një intervistë për emi-

Nis monitorimi i furrave për çmimin e bukës - Autoriteti i Konkurrencës, në terren për kontrollin e sjelljeve abuzuese

(Vijon nga faqja 2)

masën deri në 10% të xhiros së vitit financiar paraardhës të ndërmarrjeve të përfshira në marrëveshje të paligjshme.

Me sistemin e ri të tarifimit të energjisë për furrat, të vetmet që nuk u preken nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike ish in furrat e bukës, që nuk kanë asnjë aktivitet tjetër të integruar, ku çmimi vijon të jetë 7.6 lekë/kwh. Ndërkohë që, për ato ambiente që kanë furra buke, produkte pastiče-

rie apo dhe produkte të tjera të brumërave, çmimi i aplikuar është 9.5 lekë/kwh. Kategoria e tretë përfshin ato ambiente që

janë më të zgjeruara e që kanë të përfshirë bar dhe kafe, për të cilat çmimi i energjisë elektrike është 12 lekë/kwh.



Rama: U kthye nga Italia, i riu ka tashmë mbi 5 mijë rrënjë ullinj dhe 50 punëtorë

Kryeministri Edi Rama ndau historinë e Fatjonit, i cili është kthyer nga Italia në Kaninë dhe falë punës ka arritur të ketë mbi 5 mijë rrënjë ullinj dhe një ekip prej 50 punëtorësh.

"Kur vendosi të kthehej nga Italia, Fatjoni e kishte ndarë mendjen t'u kushtoj tokave të vendit të tij, kodrave me diell që shohin nga deti, në Kaninë.

E nisi punën me shumë pak dhe sot ka më shumë se 5 mijë rrënjë, kalinjtë shekullor, të rritur në një ballkon historik që nuk i ngjan asnjë tjetri", shkruan Rama.

"Tashmë, me një ekip prej 50 punëtorësh, prej shtatorit deri në nëntor, mbledhin



ullinjtë për të prodhuar vajin këto toka të bekuara", thekson kryeministri Rama.

Fabrika në Vlorë, standarde cilësore në prodhimin e vajit të ullirit

Shqipëria renditet në një nga vendet kryesore në Europë sa i takon rritjes dhe prodhimit të ullirit, me rreth 12 milionë


të ndjeshme, falë subvencioneve dhe skemave për mbrojtjen e ullirit që kanë shtuar prodhimin e kësaj bime.

ndau në rrjete sociale momente nga procesi i përpunimit dhe prodhimit të vajit të ullirit nga një prej fabrikave në Vlorë, që ka investuar në teknologji moderne të përpunimit të ullirit.

"Është një nga proceset më të bukura të stinës, nga përzgjedhja e kujdesshme e ullinjve nga "Agrothana" e deri te procesi i nxjerrjes së vajit të pastër të ullirit, në fabrikën "Naxhi Llanaj" në Novoselë", shkruan Denaj.

Prodhimi vendas i ullinjve mbulon nevojat e konsumit në tregun vendas dhe pjesa më e madhe e këtij prodhimi kalon në përpunim, për vaj ulliri.

Investimet në industrinë përpunuese të vajit të ullirit, kanë përmirësuar cilësinë e standardet e këtij produkti, i cili tashmë është mjaft i kërkuar edhe për eksport, edhe në tregjet europiane.



rrënjë ullinj, nga të cilat rreth 11 milionë janë në prodhim.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, për vitin 2023 u prodhuan 117.6 mijë tonë ullinj, ndërsa në 2024 ky tregues është me rritje

Prodhimi i vajit të ullirit është traditë mjaft e vjetër në Shqipëri, por vitet e fundit ai ka fituar një vëmendje të shtuar.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj

Sezoni i ullirit, "ikin në Greqi për 60-70 euro/dita" - Fermerët shqiptarë joshen nga ofertat e punës në vendin fqinj

Teksa i afrohem sezonit të vjeljes së ullirit, në vend vuhet shumë mungesa e fuqisë punëtore për shkak se individët në zonat rurale largohen në Greqi për një pagesë joshëse që ofron shteti "Helen".

"Sistemi i pagesave në Greqi është më i mirë. Janë mësuar vit për vit sikur fitojnë më shumë atje, ku pagesa shkon nga 60-70 euro në ditë, më tepër jo. Ndërsa në Shqipëri pagesa shkon deri në 40 mijë lekë të vjetra. Momentalisht tregu kërkon fuqi punëtore, por është e vështirë për ta gjetur," shprehet pronari i një fabrike vaji.

Nga ana tjetër është dhe mungesa e të rinjve të cilët kanë ulur pjesëmarrjen e tyre në tregun bujqësor për shkak të mentalitetit që kanë ose të

migrimit masiv që kryhet në zonat urbane.

"Ka ikur rinia duke lëvizur në Greqi. Këtu nuk ka fuqi punëtore, brezat që po vijnë nuk po shfaqin interes për sektorin, duke u shfaqur dembel ndaj punëve të sektoerit në

bujqësi".

Mungesa e fuqisë punëtore ka qenë përherë një problematikë e shtuar për pronarët e parcelave të ullinjve kryesisht në qarkun e Fierit. Duke bërë që në disa raste të ngelen dhe ullinj pa vjelje.





SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



KËNDI I BOTIMEVE TË REJA PËR BUJQËSINË

NGROHJA GLOBALE DHE TEKNOLOGJITË BUJQËSORE ZBATUAR NË NIVEL FERME, TË CILAT KUFIZOJNË RREZIQET E SAJ



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Pasojat negative nga ngrohja globale e klimës, janë sot ndër rreziqet më të mëdha, të cilat kërcënojnë bujqësinë në të gjitha elementët e saj. Këto rreziqe po vijnë me kosto shumë të madhe. Ngjarjet e rënda që po sjell klima, po krahasohen me luftrat pushtuese. Po vjen koha që buxheti që caktohet për mbrojtjen e vendit të jetë i barabartë me mbrojtjen nga kërcënimet e klimës. Na duhet të bëjmë një kompromis, ndonëse jo i këndshëm. Konkretisht, më mirë zhvillime më të ngadalshme, por të sigurta, se sa të bëhen investime të mëdha, por pa buxhet për mbrojtjen e tyre nga rreziqet e klimës.

Natyrisht vendet e vogla dhe vendet e mëdha, por të painedustrializuara, ndikojnë pak në ngrohjen globale, por rreziqet ndaj këtyre fenomeneve nuk i frenojnë dot. Ajo që mund të bëjmë është të marim masa, të cilat na zbusin deri në maksimumin e mundshëm rreziqet e ngrohjes globale.

Burimi i ngrohjes globale është hapja e hapësirave në zonën e shtresës së Ozonit. Shtresa e Ozonit është si një çadër gjigande, e cila pengon depërtimin e rrezeve infra të kuqe në atmosferë, rreze të cilat ngrohin shtresat e ajrit pranë tokës. Hapësirat, ose ndryshe, të çarat në "çadrën" mbrojtëse të stresës së Ozonit e shkaktojnë gazrat, ku më kryesorët janë gazi karbanik (CO₂), metani (CH₄) dhe Oksidi i Azotit, (NO₂). Këto gazra prodhohen nga industrializimi, transporti, bujqësia etj. Ndonëse për mbi 100 vite temperatura globale është rritur mesatarisht, më pak se sa 2°C, përsëri këto shifra në dukje të vogla, sjellin ndryshime të mëdha cilësore të klimës. Këto tempertatura herë sjellin thatësira të mëdha e të zgjatura, herë ngrica të forta dhe shpesh shira të rrëmbyeshëm dëmprurës.

Me rëndësi është të kuptohet se edhe në nivel ferme kemi mundësi të zbusim ose të parandalojmë dëmet e ngrojes globale të klimës. Më poshtë kemi rreshtuar disa praktika dhe teknologji bujqësore, të cilat janë të mundshme të zbatohen në nivel ferme, të cilat zbusin rreziqet që sjellin ngjarjet e padëshirueshme të shkaktuara nga grohja globale e klimës.

1. KOMPOSTIMET E MBETJEVE ORGANIKE ME ORIGJINË TË NDRYSHME

Burimet: - Leshterikët që vijnë nga bimësia në dete.

- Mbetjet organike të bimësisë në nivel ferme.
- Mbetjet organike të plehrave të bagëtive
- Mbetjet organike të pularive
- Mbetjet organike të bërsive të ullirit
- Mbetjet organike të bërsive nga përpunimi i rrushit të verës dhe rakisë
- Mbetjet organike nga përpunimi i bimëve mjeksore për prodhim ekstraktesh
- Mbetjet organike të sharrave dhe zdrukthtarive
- Mbetjet organike që mbesin pas të vjelave të prodhimeve

Ndikimet pozitive: - Këto pakësojnë emëtimin e gazit karbonik CO₂ në atmosferë

- Kompostimet e mbetjeve bimore shërbejnë si pleh organik dhe kufizon plehrat kimike
- Ruan mjedisin nga mbetjet organike
- Higjenizon mjedisin nga mikrobet e sëmundjeve mbi njerëz, kafshë dhe shpendë

2. ENERGJIA DIELLORE (Panelet)

- Në ferma për të vënë në lëvizje pompat për ujitjen e

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

bimëve

- Ngrohje ndërtesash në pikat agroturistike dhe turistike
- Ndrëçim rrugësh dhe semaforësh
- Ndrëçim dhe ngrohje uji për feramat blegtorale në mal

Ndikimet pozitive: - Kufizojnë përdorimin e lëndëve djegëse si nafta, qymyri, drurët e pyllit dhe mbron mjedisin nga tymrat dhe gazrat me ndikim në fenomenin serrë

3. MBJELLJA E BREZAVE PYJOR DHE OAZE EKOLOGJIKE PYJORE

Brezat me drurë pyjorë mbillen si anës ngastrave, ose parcelave të vogla me bimë pyjore, si elementë të pasurimit të agroekosistemit dhe të pejsazhit.

Ndikimet pozitive: - Pengojnë si erërat e ftohta, ashtu edhe rrymat ajrore të ngrohta, të cilat rrisin avullimin e bimëve.

- Këto breza janë vendstrehimi për shpendët dhe insektet e dobishëm dhe insektet pjalmues.
- Rritja e sipërfaqes së gjelbëruar rrit sipërfaqen e thithjes nga ajri të CO₂
- Përmirëson ekosistemin dhe biodiversitetin

4. MBJELLJA E KULTIVARËVE REZISTENTË NDAJ SËMUNDJEVE, DËMTUESVE, NDAJ THATËSIRËS DHE TEMPERATURAVE TË ULËTA

Këto kultivarë janë të prodhuar nga qendrat shkencore dhe janë shumë nga fidanishtet për ngritjen e blloqeve në nivel ferme

Ndikimet pozitive: - Kufizon përdorimin e pesticideve, të cilët kërkojnë energji edhe për t'u prodhuar, edhe për të spërkatur bimët.

- Rrisin higjenën e mjedisit
- Ulin koston e mbrojtjes së bimëve

5. PËRDORIMI I BIMËVE BISHTAJORE AZOTPRODHUESE, SI DHE BIMA KONFREJ (Symphytus officinalis)

Burimet: batha, bizelja, bima Komfrej, trifilet dhe përzjerjet e tyre.

Ndikimet pozitive: - Pengojnë gërryerjen e tokës në dimër

- Rrisin sipërfaqen e gjelbëruar duke ndikuar në lidhjen në bimë të gazit karbonik CO₂
- Kufizojnë përdorimin e plehrave kimike të cilët kërkojnë energji edhe për t'i prodhuar edhe për t'i shpendarë në fusha e kodra
- Janë mbështetëse të shtimit të insekteve të dobishëm dhe pjalmuesve

6. PËRDORIMI I FEROMONEVE ÇORIENTUESE TË ÇIFTËZIMIT TË INSEKTEVE

Burimi: - Nga industria kimike e produkteve biologjike për mbrojtjen e bimëve

Ndikimet pozitive: - Kufizon përdorimin e insekticideve konvencionalë deri në masën 80%.

- Menjanojnë kimikatët në fruta dhe produktet e përpunuara
- Mbron mjedisin dhe faunën e dobishme nga mbetjet kimike
- Kufizon harxhimin e energjisë në prodhimin dhe shpërndarjen e tyre në spërkatjen e bimëve.

7. PËRDORIMI I DIXHITALIZIMIT NE BUJQËSI

Fushat e zbatimit: - Aparatura elektronike për prognozimin e sëmundjeve dhe dëmtuesëve të bimëve

- Përdorimi i rrjeteve për gjetjen e tregjeve dhe të buletinit të çmimeve
- Prognozimin e motit që parashikojnë ngjarjet klimatike të vështira si përmbytje, thatësira, ngrica.
- Informacione elektronike mbi kanalet e marketingut.
- Shërbim Këshillimor i dixhitalizuar

Ndikimet pozitive: - Këto teknologji, kufizojnë lëvizjet e panevojshme me mjete transporti, për mjete për trajtimin e bimëve, mjete dhe energji për riparimin e defekteve që vijnë nga ngjarjet klimatike.

8. PËRDORIMI I UJIT TË SHIUT PËR QELLIME UJITJEJE

Burimet: - Uji i shiut i grumbulluar nga çatitë e shtëpive

- Uji i shiut i grumbulluar nga çatitë e serrave
- Uji e shiut i grumbulluar në rezervuarët me diga të vogla ose të mëdha

Ndikimet pozitive: - Uji i shiut i grumbulluar përdoret duke kursyer energjinë për ta marrë atë nëpër tuba, me pompa që punojnë me lëndë djegëse,

9. PËRDORIMI I LESHTERIKËVE SI SUBSTRAKT PËR RRITJEN E BIMËVE BUZË LUMENJËVE

Burimi: Në brigjet e detit

Kjo përdor mbetjet bimore si pleh, si dhe mbron brigjet e lumenjëve nga gërryerjet e tokës. Këto rezerva organike kufizojnë përdorimin e plehrave kimike.

10. RRITJA E PRODHIMIT DHE KONSUMIT TË PRODUKTEVE VENDASE

Burimi: - Rritja e sipërfaqes së mbjellë

- Rritja e volumit të prodhimit në njësinë e sipërfaqes.
- Modernizimi i mekanizimit
- Inovacione në teknologjitë e prodhimit dhe përpunimit.
- Vazhdimësi prodhimi
- Shumëllojshmëri produktesh

Ndikimet pozitive: - Kjo kufizon rrugët e transportit të produkteve nga distanca të largëta, e aq më pak duhet të importohet, ku impakti në mjedis është negativ.

- Rrit të ardhurat e fermave dhe investimet në ferma dhe njësitë e përpunimit
- Rritet pavarësia ushqimore

11. MULÇËRIMI/ MBULLIMI I TOKËS ME MBETJE ORGANIKE

Burimet: - Mbetjet bimore pas krasitjeve - Bari pas kositjeve të mezhdave - Kashta dhe byku pas korrjeve

Ndikimet pozitive: - Kufizon përdorimin e plehrave kimike.

- Menjanon erozionin e tokës - Kufizon numrin e barërave të egra

Këto të gjitha së bashku kursejnë energjitë për plehërimin e bimëve dhe masat për rregullimin e barërave të egra në fushat e prodhimit.

12. PËRDORIMI I SUBSTANCIVE HIDROFILE, SI REGULLUESE TË REZERVAVE TË UJIT NË TOKË

Burimi: Nga industria e prodhimit të produkteve miqësore me mjedisin

Ndikimet pozitive: - Këto lloje substancash grumbullojnë ujin e tokës rreth vetes.

Shërbejnë si një sfungjer thithës. Këtë ujë bima e përdor gradualisht edhe në motin e thatë.

- Këto metoda kursejnë energjitë që harxhohen për ujitjen e bimëve

13. PËRDORIMI I SISTEMIT TË UJITJES SË BIMËVE ME PIKA

Burimet: Burimet e ndryshme ujore

Ndikimet pozitive: - Ky sistem ujitje kusen energjinë që përdoret për ujitje

- Kursen rezervat ujore që përdoren për ujitjen e bimëve.
- Menjanon gërryerjen e tokës.

NGROHJA GLOBALE DHE TEKNOLOGJITË BUJQËSORE ZBATUAR NË NIVEL FERME, TË CILAT KUFIZOJNË RREZIQET E SAJ

(Vijon nga faqja 10)

14. PËRDORIMI I KAFSHËVE NË PUNËT E BUJQËSISË

Burimi: - Rritja e kafshëve si kuaj dhe qetë e punës në ferma

Ndikimet pozitive: - Përdorimi kuajve dhe qeve të punës për punimet në bujqësi ndihmon fermerët e vegjël të kursejnë lëndë djegëse që përdoret në punimet, kultivimet dhe operacionet e tjera

15. MEKANIZIMET E VOGLA NË BUJQËSI

Burimi: Importi ose prodhimi artizanor në vend

Ndikimet pozitive: - Këto mekanizma, janë shumë të efektshme për fermat e vogla.

Këto mekanizma përdoren për mbjellje, kultivim, kositje, korrije zëvendësojnë mekanizmat e mëdha, të cilat harxhojnë energji të parinovueshme dhe janë shumë të kushtueshme për fermerët e vegjël dhe të mesëm.

16. PUNIMET MINIMALE TË TOKËS

Burimi: - Mjetet bujqësore - Këto punime janë vetëm disa centimetra dhe jo me përmbysje të tokës si në plugimet e thella. Kjo kursen lëndë djegëse të parinovueshme, të cilat përdoret nga mjetet mekanike të rënda

- Ruan më mirë florën dhe faunën e tokës
Nuk përmbys në thellësi lëndën organike të shtresës së sipërme të tokës.

17. SKEMAT E QARKULLIMIT BUJQËSOR TË PARCELAVE NGA VITI NË VIT

Burimi: - Fushat e prodhimit dhe bimët bujqësore

Ndikimet pozitive: - Kufizon plehërimet e tepërta -Kufizon insekticidet dhe fungicidet e tepërta
- Kufizon përdorimin e herbicideve për rregullimin e barërave të egra

18. NDËRTIMET NË VENDE JASHTË RREZIKUT TË PËRMBYTJEVE SI PËR SHTËPITË E BANIMIT, STALLA, MAGAZINA, FABRIKA PËRPUNIMI, TREGJE etj.

Burimi: - Ligjet e shtetit - Zyrat e urbanistikës dhe miradministrimit të territorit

- Lejet e ndërtimeve të jepen duke pasur parasysh edhe shmangien e përbytyjeve nga përrrenjtë, lumenjtë, nga luginat ujëmbledhëse etj. Në ndërtime, duhen pasur parasysh edhe drejtimet e erërave të forta.

- Kur përzgjidhen kultivarët e pemëve, ullirit, hardhive, perimeve etj., duhet të merren parasysh se si sillen këto

kultivarë ndaj temperaturave të ulëta dhe thatësirës.

19. MASAT PËR MBROJTJEN E TOKËS NGA GËRRYERJET

Burimi: - Materiale Brenda fermës - Materiale jashtë fermës


Ndikimet pozitive: -Të gjitha bashkë këto elemente parandalojnë gërryerjen e tokave nga ngjarjet klimatike. Objekte mbrojtëse si prita, tarracime, kanalizime, - Mbulesa e tokës me bimësi gjithëvjetoje (jonxha, trifilet, bimët plehëruese si batha, lupini, bizelja, bimë forogjere të veçanta ose të përziera për të shtuar biomasën.

20. PËRFSHIRJA E BIZNESEVE DHE BANESAVE NË SISTEMIN E SIGURIMEVE FINANCIARE

Bizneset duhet të paguajnë kuotat e sigurimeve për t'u mbrojtur financiarisht nga shoqëritë e sigurimeve, në raste të aksidenteve të shkaktuara nga ngjarjet e rënda klimatike

Ndikimet pozitive: - Fermat dëmshpërblehen nga kompanitë e sigurimeve në rast të dëmtimit nga ngjarjet e rënda të klimës, të tokës bujqësore, prodhimeve, objekteve të ndërtimit etj.

Ndikimi i gazrave në fenomenin "serrë" të ngrohjes globale të klimës



Përmbytjet, thatësirat e zgjatura, zjarret në pyje, shkaktuar nga fenomenet e ngrohjes globale të klimës.



Siç shikohet, gazrat me ndikim më të madh në prishjen e shtresës së Ozonit janë: Gazi Karbonik (CO2) me ndikim 56.4 %, Metani (CH4) me 16,3 % dhe Oksidi Azotit (NO2) me 10,2 % ndikim negativ mbi shtresën e Ozonit, si çadra mbrojtëse e tokës nga temperaturat e larta mbi normalen.



Industria dhe transporti, burime të mëdha të gazrave, shkaktarë të shkatrrimit të shtresës mbrojtëse të Ozonit.

AGROTURIZËM

Të huajt "braktisin" jugun për veriun - Çmimet e larta të hoteleve në bregdet zhvendosën pushuesit në mal

Ngadalësimi i turizmit gjatë muajit korrik ka nxjerrë në pah disa abuzime të dukshme me çmimet, veçanërisht në zonën e jugut të Shqipërisë. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT,

qeverisë për ardhjen e 14 milionë turistëve në vitin 2024.

Analiza e platformës "Booking" tregon se hotelet në Vlorë dhe Sarandë ofrojnë çmime që janë dukshëm më të larta kra-

dhomë për tre persona për rreth 14 mijë lekë nata, ndërsa në veri, çmimet për të njëjtin standard variojnë rreth 10 mijë lekë, ose ndonjëherë edhe më pak.

Ky fenomen ka rezultuar në një përmirësim të dukshëm të turizmit malor, i cili po fiton terren përballë turizmit bregdetar. Rritja e numrit të vizitorëve në veriun e vendit tregon se turistët po preferojnë alternativa më të lira dhe me cilësi më të mirë, duke përfituar nga ofertat më konkurruese. Kjo situatë thekson nevojën për një rregullim më të fortë të politikave të çmimeve dhe për një mbikëqyrje më të madhe nga autoritetet për të garantuar



TË HUAJT "BRAKTISIN" JUGUN PËR VERIUN
ÇMIMET E LARTA TË HOTELEVE NË BREGDET ZHVENDOSËN PUSHUESIT NË MAL

gjatë dy muajve të parë të verës, shtetasit e huaj regjistruan rreth 235 mijë netë qëndrime në veri, duke shënuar një rritje prej rreth 40% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në kontrast, zona e jugut përjetoj një zbehje të numrit të netëve qëndrimeve, me një rritje më modeste prej 27%. Kjo rritje më e ulët lidhet kryesisht me abuzimet me çmimet që hotelet në jug kanë bërë në përpjekje për të kapitalizuar parashikimet optimiste të



TË HUAJT "BRAKTISIN" JUGUN PËR VERIUN
ÇMIMET E LARTA TË HOTELEVE NË BREGDET ZHVENDOSËN PUSHUESIT NË MAL

hasuar me vitin e kaluar. Një hotel me 4 yje tani ofron një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në të gjithë vendin.

Zona Pishë Poro-Nartë shpallet peizazh i mbrojtur ujor e tokësor

Këshilli i Ministrave shpalli peizazh i mbrojtur ujor e tokësor të kategorisë V zonën Pishë Poro-Nartë, me sipërfaqe 16 124.61 ha.

Përbëhet nga dy pjesë: Pishë Poro dhe Narta. Akumulimi, në zonën e Pishë Poros, aktualisht,

Nartës komunikon me detin. Laguna ka thellësi të vogël, mesatare 1.2 m dhe maksimalja rreth 2 m. Kodra e ulët e Zvërnecit formon një ishull në lagunë.

Pjesa veriore e lagunës është kthyer në kripore në fillimet e

bytja herë pas hershme.

Rajoni është i njohur për florën e veçantë dhe larinë e habitateve, me vlera të veçanta shkencore, ekologjike (shumë gjallesa të rralla) dhe ekonomike (bimë mjekësore, aromatike, industriale dhe dekorative). Mendohet se në të rriten të paktën 800 bimë enësore. Takohen rreth 25 lloje bimësh të rrezikuara. Me interes të madh cilësohet sidomos Orchis albanica dhe forma hibride Orchis paparisti, ndërsa 67 lloje cilësohen me interes ekonomik dhe shkencor.

Narta është laguna e dytë në vend për nga rëndësia për shpendët e ujit. Më të zakonshme janë rosat dhe bajzat. Gjatë sezonit të folezimit, Narta kthehet në vendin e shumimit për lloje të shumta shpendësh uji. Afro 88% e tyre përqendrohet në kriporet. Narta është vendshqimi për pelikanin (Pelicanus crispus), por takohen rregullisht flamingot (Phenicopter ruber).

Po ashtu qeveria shpalli peizazh të mbrojtur të kategorisë V edhe zonën "Kuturman - Qafë Bushi", me sipërfaqe 4 160.26 ha, mbështetur në vlerat natyrore, të biodiversitetit, të mbulesës vegetative, vlerat biologjike, kulturore, historike e trashëgimore, që ka në tërësi ky ekosistem natyror.



zhvillohet në të dy anët e grykëderdhjes së kanalit kullues të Povelçës, në rreth 7 km gjatësi.

Laguna e Nartës (41,5 km²), bën pjesë në lagunat e mëdha të bregdetit tonë të Adriatikut. Në skajin jugor të lagunës ngrihen kodrat e ulëta terrigjene të Triportit, të cilat, nëpërmjet brezit litoral, lidhen me skajin jugor të deltës së Vjosës. Ky brez litoral, i mbuluar në pjesën më të madhe me pisha, veçoi lagunën nga deti. Në të janë dy kanale natyrore, nëpërmjet të cilave laguna e

viteve 1950. Kriporja zë rreth 1 500 ha dhe ndahet nga laguna me argjinaturë. Përbëhet nga shumë pellgje të cekëta dhe ishuj të vegjël, të përshtatshëm për shpendët folezues të ujit. Dallohet për botë të gjallë të pasur dhe të larmishëm, ku dallohen shpendët ndenjtarë dhe shtegtarë.

Laguna e Nartës së bashku me deltën e Lumit Vjosa, Lagunen e Kallëngas dhe Kepin e Dajlanit, janë formuar nga prurjet aluvionale të Lumit të Vjosës dhe karakterizohet nga cektësia dhe përm-

Britania e Madhe mbështet zhvillimit të qëndrueshëm rural e turistik në veri të Shqipërisë

Britania e Madhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe të turizmit në veri të Shqipërisë.

Në një postim në rrjetet sociale, Ambasada britanike në Tiranë, njofton se sot ambasadori Britanik, Nick Abbott, nënshkroi një marrëveshje për zgjerimin e projektit të GIZ për zhvillim të qëndrueshëm rural në Shqipërinë e Veriut.

"Ky bashkëpunim përfshin partneritetin me Gjermaninë dhe Zvicrën, duke mbështetur bujqësinë dhe turizmin në rrethet e Kukësit dhe Dibrës. Projekti synon të kontribuojë në rritjen dhe mirëqenien e kë-



tyre komuniteteve rurale, duke ndërtuar një të ardhme më të ndritshme për to", njofton Ambasada britanike në Shqipëri.

Lumi Vjosa për në UNESCO, Pirushi: Dosja gati për nominim, aplikojmë këtë vit

Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Daniel Pirushi, në një intervistë për


nominim e lumit Vjosa, për të qenë pjesë e UNESCO-s.

Pirushi tha se dosja është gati. "Ne aplikojmë këtë vit. Brenda

